



*Qëllim misionar, drejtim vizionar, mendim kritik & iniciativë krijuese*  
*Qëndrime të bazuara në vlerat e përbashkëta*  
*Këto, së bashku, përcaktojnë rrugën tonë*

### STRATEGJIA E ÇËSHTJEVE STUDENTORE

**Përmbajtja:**

**Hyrje**

**1. Objektivat, sfidat dhe parimet bazë**

**2. Komuniteti "Marin Barleti"**

**3. Studenti në qendër**

- A. Programe studimi të akredituara, cilësore e specifikuara të orientuara
- B. Konceptimi i universitetit si shkollë demokracie
- C. Pjesëmarrje aktive në sferën publike shqiptare
- D. Shumëllojshmëri formash të (vet)vlerësimit të dijeve e kontributeve
- E. Statusi dhe karta e studentit
- F. Vlerësimi i brendshëm dhe përcaktimi i prioriteteve

**4. Profile, kritere dhe procedura të përzgjedhjes së studentëve**

- A. Cilësia e studentëve që pranohen
- B. Të tjera çështje mbi përzgjedhjen e studentëve
- C. Prezantimi i ofertës "Marin Barleti"
- D. Publikimi dhe mediatizimi i ofertës "Marin Barleti"
- E. Politikat e motivimit (Bursa, sponsorizime studimesh)

## **5. Orientimi dhe shërbimet për studentët**

- A. Orientimi dhe zhvillimi i karrierës
- B. Tutoriali
- C. Studentët në prag të diplomimit
- D. Studentët e diplomuar (Alumni)

## **6. Të tjera shërbime për studentët**

- A. Biblioteka
- B. Shërbimet akademike dhe administrative të informatikës
- C. Aktivitetet universitare; Zyra e aktiviteteve
- D. Jeta studentore jashtë-universitare
- E. Akomodimi
- F. Qendra e këshillimit psiko-social

## **7. Partnerët, bashkëpunëtorët, ambasadorët**

- A. Partnerët
- B. Bashkëpunëtorët
- C. Ambasadorët

## **8. Ndërkombëtarizimi i studentëve**

Krijimi i komunitetit anglishtfolës "Marin Barleti"

## **9. Divizioni i çështjeve studentore, çështjet që mbulojnë, kontaktet**

## **10. Organograma Divizionit të Çështjeve Studentore**

\* \* \*

## Hyrje

“Strategjia e çështjeve studentore” (në vijim SÇS) përmban një tërësi platformash të veçanta të sektorëve që, së bashku, formojnë “Divizionin, ose Grupin e çështjeve studentore” (në vijim DÇS) të Universitetit “Marin Barleti”.

SÇS është hartuar nga Divizioni i Çështjeve Studentore, nën drejtimin e Prorektorit të Çështjeve Studentore. Ajo është prezantuar para personelit akademik të Universitetit “Marin Barleti”, në muajin maj 2010 dhe është miratuar nga Senati Akademik i tij.

SÇS mbështetet në përvojën e e Universitetit “Marin Barleti”, në vizionin dhe objektivat afatmesme dhe afatgjata të themeluesve dhe administratorëve të tij, si dhe në përvojën e universiteteve të ndryshme vendase dhe të huaj, veçanërisht të atyre universiteteve me të cilët janë vendosur kontaktet dhe janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi (Universiteti i Cardiff-it në Angli; Clemson University në SHBA; Universiteti i Udines-Itali etj.)

SÇS u përmbahet kërkesave të ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore të tij dhe udhëzimeve të MASH, si dhe dokumenteve themelore të Universitetit “Marin Barleti” (statuti, rregullorja etj.).

Objektivat që përmban SÇS janë objektiva të vetë Universitetit “Marin Barleti”, të Rektoratit, fakulteteve, departamenteve dhe administratës së tij. Për realizimin e tyre GÇS bashkëpunon dhe koordinon me të gjitha subjektet që janë pjesë e projektit madhor “Marin Barleti”.

Në SÇS janë pasqyruar dhe konkretizuar kriteret bazë të akreditimit kombëtar e ndërkombëtar të institucioneve të arsimit të lartë.

SÇS rishikohet dhe përmirësohet në përputhje me interesat e studentëve, me kërkesat, propozimet dhe sugjerimet e tyre, të shprehura në pyetësorin e vlerësimit të brendshëm semestral dhe përmes Unionit studentor, këshillave dhe shoqatave studentore.

### **1. OBJEKTIVAT, SFIDAT DHE PARIMET BAZË**

Objektivi kryesor i DÇS është ai i Universitetit “Marin Barleti”, i cili është dhe synon të mbetet një institucion elitar i arsimit të lartë në Shqipëri dhe në rajon, në krye të hierarkisë universitare shqiptare, një qendër e madhe e mendimit dhe përgatitjes profesionale e qytetare.

GÇS si pjesë e Universitetit “Barleti” synon të përballojë sfida e kohës dhe të krijojë një përvojë origjinale kombëtare dhe rajonale për përgatitjen e specialistëve e shkencëtarëve të rinj, si dhe të qytetarëve aktivë të interesuar për çështjet publike.

Parimi udhëheqësi i Universitetit Barleti është: *Studenti në qendër.*

Të tjera parme të rëndësishme janë:

*Perceptimi universitetit si komunitet (Komuniteti “Marin Barleti”);*

*Organizimi dhe funksionimi i rrjeteve me studentë potencialë, studentë aktivë, studentë të diplomuar (alumni), bashkëpunëtorë, ambasadorë, miq dhe institucione partnere (akademike, të shoqërisë civile, të sipërmarrjes etj.).*

GÇS i përmbahet parimit të punës në grup, ku çdo sektor i veçantë është hallkë e një zinxhiri, forca e të cilit është sa forca e hallkës së tij më e dobët.

SÇS synon qartësimin e funksioneve, përgjegjësi dhe kompetencave të individëve që përbëjnë DÇS, koordinimin dhe harmonizimin e veprimeve ndërmjet tyre, në funksion të përmbushjes së misionit të universitetit, si i tërë.

SÇS bazohet në vetë misionin e DÇS, si një ndër hallkat e Universitetit Barleti që merret ekskluzivisht me gjithë problematikën studentore në tre nivele, që janë:

1. “Studentë potencialë”, studentët e ardhshëm të universiteti Barleti, që synohet të tërhiqen nga niveli parauniversitar dhe nga tregu i punës për nivelin pasuniversitar;

2. “Studentë aktivë”, ata që vijojnë studimet, në nivel universitar e pasuniversitar, pranë Universitetit Barleti;

3. “Barletas të diplomuar” (barletas alumni), ata që kanë kryer studimet pranë Universitetit Barleti dhe, si pjesë e përhershme e komunitetit Barleti, janë përfitues të përhershëm të një sërë shërbimesh që universiteti ofron për plotësimin e njohurive në përputhje me dinamikën e zhvillimit, për përshtatjen e ri-pozicionimin e tyre në tregun e punës të tilla si trajnime afatshkurtra, kurse e shkolla verore; seminare e aktivitete shkencore, sensibilizuese, promovuese etj.; libra e periodikë shkencorë, broshura e materiale të tjera të Universitetit “Marin Barleti” etj. (shih më poshtë, 5-D: Studentët e diplomuar; Alumni)

SÇS është pjesë e një universitetit të hapur që, për përmbushjen e misionit të tij, vendos dhe zhvillon marrëdhënie partneriteti me institucione dhe subjekte të tjera vendase dhe ndërkombëtare me të cilat ai ndan interesa të përbashkëta.

## **2. KOMUNITETI “MARIN BARLETI”**

Komuniteti “Marin Barleti” përbëhet nga studentët marinbarletas të kategorive të ndryshme, personaliteti akademik e administrativ, bashkëpunëtorët, partnerët dhe ambasadorët.

Me Komunitetin “Marin Barleti” synohet:

Krijimi i një identiteti të veçantë kulturor në nivel kombëtar, rajonal e më gjerë;

Rritja e ndjenjës së krenarisë së të qenit pjesë e këtij komuniteti dhe e Universitetit “Marin Barleti”;

Krijimi i rrjeteve të ndryshme të komunikimit (virtuale dhe jo vetëm);

Vendosja e lidhjeve të përhershme të Universitetit “Marin Barleti” me studentët e diplomuar (barletasit alumni), sikurse me partnerët, bashkëpunëtorët dhe ambasadorët.

Shndërrimi i universitetit dhe komunitetit “Marin Barleti” jo vetëm në një qendër të madhe të arsimit e të përfitimit të dijeve gjatë gjithë jetës, por edhe në një qendër të madhe të kulturës, e në një shkollë të mendimit.

Për këto:

Të themelohet *Dita e Marinbarletasve* (duke përfshirë studentët alumni). Në kuadrin e saj të organizohen me një program të veçantë *Java e Marinbarletasve*, që të përfshijë ceremoni, spartakiada universitare e aktivitete të gjithanshme kulturore e shkencore.

Organizimi i veprimtarive për zgjerimin dhe kompaktësimin e komunitetit “Marin Barleti”, rritjen e krenarisë dhe vetëvlerësimit për të qenët pjesë këtij projekti, në të gjithë komponentët e tij;

Vlerësimi i veprës shumëdimensionale të Marin Barletit, si themeluesi e përfaqësuesi kryesor i mendimit shqiptar, në rrafsh historik, filozofik, sociologjik, psikologjik, politologjik, socio-linguistik etj., dhe prezantimin në konferenca, simpoziume, botime etj.;

Krijimi i Muzeut “Barleti dhe barletasit”, në të cilën të përfshihet vepra barletiane dhe vepra e barletasve (historiku i universitetit);

Zgjerimi i Bibliotekës Barleti dhe krijimi i bibliotekës on-line Barleti;

Nxitja e krijimit të shoqatave, klubeve dhe sidomos rrjeteve me emrin “Barleti” (me ish-studentë, studentë, bashkëpunëtorë, miq);

Nxitja e një lëvizjeje për humanizimin e shoqërisë shqiptare, mbështetur edhe në mendimin humanist barletian, pjesë e rëndësishme e humanizmit evropian dhe botëror.

Vendosja e partneritetit me institucione të rëndësishme të shoqërisë shqiptare, me shoqata, klube, me komunitetet lokale etj.;

Vendosja e kontakteve me universitete të huaja (italiane, franceze, gjermane etj.), që kanë departamente apo katedra të gjuhës e kulturës shqiptare;

### **3. “STUDENTI NË QENDËR”**

Parimi bazë i SÇS është: “studenti në qendër”. Ky parim udhëheqës buron nga filozofia e Universitetit “Marin Barleti” dhe synimi i tij *për një përgatitje të dyfishtë të studentit: profesionale dhe qytetare.*

Në veçanti, shkollimi i bazuar në parimin “Studenti në qendër”, përmban:

#### **A. Programe studimi të akredituara, cilësore e specifikuara të orientuara**

Programe studimi cilësore e të orientuara për përgatitjen e studentit *me aftësi e shprehje praktike*, për aftësimin e tij për të konkurruar drejtpërdrejt në tregun shqiptar e ndërkombëtar të punës;

Programe studimi cilësore e të orientuara për përgatitjen e studentit *si qytetar aktiv* e i interesuar për çështjet publike;

Programe të diferencuara studimi e trajnimi të bazuara *në studimin e detajuar të formimit parauniversitar të studentëve, në prirjet, talentin, interesat si dhe në mangësitë e formimit të mëparshëm*;

#### **B. Konceptimin e universitetit si shkollë demokracie**

Larmi formash për gjithpërfshirjen e studentëve në çdo qelizë të jetës universitare;

Përfshirjen sa më të madhe të studentëve në vendimmarrjet, në nivel universitar, fakultetesh dhe departamentesh;

Një tërësi formash (si referendume studentore, votime etj.), për realizimin e demokracisë së drejtpërdrejtë studentore dhe përfshirjen e masës së studentëve në vendimmarrjen e drejtpërdrejtë;

Procedura sa më konkurruese, tërësisht demokratike e sa më shkencore (për shembull, përmes metodës sociometrike) për zgjedhje e liderëve të Unionit Studentor, të përfaqësuesve të studentëve në institucione të ndryshme brenda dhe jashtë universitetit, për zgjedhjen e organizatorëve të aktiviteteve studentore etj.;

Mundësi për organizime alternative të studentëve, veç organizimit të kushtëzuar nga Ligji i Arsimit të Lartë (neni 55 “Këshillat e Studentëve”), konkurrencë në organizimin studentor dhe përkrahje sa më të gjerë të nismave studentore nga personeli akademik dhe administrativ;

Një tërësi formash për kompaktësimin e komunitetit studentor, si pjesa më e rëndësishme e komunitetit barletas;

Vlerësimin e çdo grupi studentor dhe kursi si një njësi komunitare, ku çdonjëri është/konsiderohet anëtar me të drejta përgjegjësi e detyrime të barabarta.

#### **C. Pjesëmarrje aktive në sferën publike shqiptare**

Pjesëmarrje sa më të madhe të studentëve, veças apo bashkë me pedagogët e tyre, në sferën publike shqiptare, në media, në komunitetet lokale etj.

Promovimi i ideve dhe praktikave për organizimin komunitar, sidomos në Tiranë.

Prani sa më të madhe të barletasve në veprimtari masive publike, në konkurse kombëtare e lokale, veprimtari kulturore, sportive etj., apo në sipërmarrje të llojeve të ndryshme me interes publik;

Nxitja e përfaqësimit të Universitetit "Marin Barleti" dhe sponsorizimi (i plotë apo i pjesshëm) i talenteve që e përfaqësojnë atë, nga fusha të ndryshme: shkenca, kultura, arti, sporti etj.

#### **D. Shumëllojshmëri formash të (vet)vlerësimit të dijeve e kontributeve**

D-1. *Vlerësimi nga pedagogët*: Vlerësim me pikë, si shumatore kontributesh, për çdo fazë dhe çdo veprimtari formuese akademike, si dhe për një sërë komponentësh, siç janë: vijimësia, niveli dhe cilësia e pjesëmarrjes në trajtimin e çështjeve, të menduarit kritik, provimet e ndërmjetme, detyrat e kursit, provimi përfundimtar;

Përfshirjen në vlerësimin e studentëve edhe të kontributeve qytetare, në një raport të dhënë me kontributet profesionale/akademike (që, sipas programeve të studimit, mund të varrojë nga 1 me 4 deri në 1 me 9);

Përfshirjen në vlerësim (me zgjedhje e kompensim, brenda një moduli të dhënë) të veprimtarive alternative, si për pjesëmarrje në konferenca shkencore, në sondazhe e veprimtari të rëndësishme (duke vlerësuar edhe relacionet shoqëruese dhe prezantimin e tyre);

Shpallja, bashkë me programin e lëndëve (në javën e parë të çdo kursi), edhe të komponentëve që përbëjnë vlerësimin e studentëve, shpjegimi dhe arritja e një konsensusi sa më të gjerë me studentët;

Transparencë dhe drejtësi në çdo vlerësim; ballafaqim me studentët dhe shpjegim i notës për çdo modul;

Raportimi i vlerësimeve të pjesshme dhe monitorimi përmes një sistemi kompjuterik në nivel universiteti/apo fakulteti (një sistem elektronik në të cilën raportohen vlerësimet dhe shumimi i pikëve dhe konvertimi në notë/dhe i germëzuar - sipas sistemit amerikan, bëhet automatikisht)

D-2. *Vlerësim i studentit nga studentët e tjerë*, sidomos për detyrat e kursit, në formë recensionimi të verbër (blind review), si recensionim i hapur, apo në forma të tjera;

D-3. *Vetëvlerësim i studentëve* për veten e tyre (për shembull me një pyetje në fund të testit);

#### **E. Statusi dhe karta e studentit**

##### **Statusi i studentit**

Statusi i studentit të Universitetit Barleti (Aneksi 1, bashkëngjitur "Statusi i studentit") fitohet me regjistrimin e studentit në Universitetin "Marin Barleti". Në të përcaktohen të drejtat dhe shërbimet kryesore të studentëve, si dhe kushtet në të cilat studenti humbet statusin e tij.

Të drejtat, detyrimet dhe shërbimet kryesore që përmban statusi i studentit barletas, u përmbahen kërkesave të neneve 53 e 54 të Ligjit "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" (LAL), si dhe statutit të universitetit Barleti.

Me marrjen e diplomës, ose certifikatës së studimeve, studenti humbet Statusin e studentit (neni 53, LAL) dhe fiton "Statusin e studentit Alumni" (Aneksi 2, bashkëngjitur "Barletasit Alumni").

Statusi i studentëve rishikohet e pasurohet periodikisht në raport me zgjerimin e gamës së shërbimeve të universitetit dhe nëse këtë e kërkojnë forumet e këshillave dhe shoqatave studentore të Universitetit "Marin Barleti".

### **Karta e studentit**

Studentët e Universitetit "Marin Barleti" pajisen me kartën e studentit, bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Karta e studentit është dokument unik. Në të shënohet numri unik i matrikullimit që i jepet studentit në momentin e regjistrimit dhe që e shoqëron atë deri në përfundimin e studimeve.

Kartat e studentit të Universitetit "Marin Barleti" u ofron atyre edhe shërbime me tarifa të reduktuara (si restorante, librari, palestra etj.), të subjekteve dhe institucioneve me të cilat ai ka marrëveshje bashkëpunimi.

Veç përfitimeve dhe shërbimeve që mbart karta e studentit e që sigurohen nga entet shtetërore (në përputhje me kriteret e vendosura nga Këshilli i Ministrave), karta e studentit barletas mbart një sërë shërbimesh të veçanta brenda universitetit e jashtë tij (Aneksi 3, bashkëngjitur "Karta e studentit").

### **F. Vlerësimi i brendshëm dhe përcaktimi i prioriteteve**

Hartimi i strategjive të zhvillimit të Universitetit Marin Barleti, i prioriteteve të institucionit dhe orientimi i politikave të tij, bëhet si rregull/kryesisht, me iniciativën e studentëve dhe në përputhje me interesat e tyre.

Për këtë;

1. DÇS, në bashkëveprim me njësinë e vlerësimit të brendshëm të cilësisë (Qendra e Vlerësimit të Brendshëm), organizon në prill-maj të çdo viti, një sondazh të përgjithshëm (me të gjithë studentët, ose me një pjesë të tyre të përzgjedhur sipas procedurave të kampionimit, ose në forma të tjera), për vlerësimin e veprimtarisë mësimore, të gamës dhe cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve dhe personelit akademik, të gamës dhe cilësisë së aktiviteteve kulturore,

artistike, sportive etj, për infrastrukturën didaktike etj. (Aneksi 4, bashkëngjitur “Pyetëtori i sondazhit të vlerësimit të përgjithshëm”).

2. Studentët (të gjithë, apo me sistem përzgjedhës) ftohen që, *në fund të çdo lënde (ose moduli)*, të japin vlerësimin e tyre për programin e modulit, niveli e përgatitjes dhe zhvillimit të leksioneve e veprimtarive të tjera formuese brenda tij, tekstet e literaturën, nxitjen e të menduarit kritik, për mënyrën dhe transparencën e vlerësimit etj. (Aneksi 5, “Pyetëtori i sondazhit të vlerësimit për module/pedagogë të veçantë”).

3. Studentët (të gjithë, apo me sistem përzgjedhës) ftohen që, *në prag të përfundimit të programit të studimeve*, të japin vlerësimin e tyre për gjithë periudhën e shkollimit të lartë dhe orientimin e tyre pasuniversitar (Aneksi 6, bashkëngjitur “Pyetëtori i sondazhit të vlerësimit për studentët para diplomimit, apo certifikimit”).

Synohet që, në bashkëpunim me institucione të pavarura – partnere të universitetit - ky sondazh të shtrihet edhe në shkolla të tjera të larta. Mbi bazën e problematikës së evidencuar dhe prirjeve të studentëve bëhet orientimi i politikave të nivelit pasuniversitar dhe alumni.

Zbatimi i parimit “Studenti në qendër” mbart shërbime të shumëllojta e cilësore për studentët (shih, më poshtë, “Shërbimet për studentët”).

#### **4. PROFILE, KRITERE DHE PROCEDURA TË PËRZGJEDHJES SË STUDENTËVE**

##### **A. Cilësia e studentëve që pranohen**

Universiteti “Marin Barleti” është dhe synon të shndërrohet gjithnjë e më shumë në një institucion të arsimit të lartë *që përzgjedh* studentët që pranohen për të vazhduar studimet në të.

Strategjia e tërheqjes dhe përfshirjes së studentëve në Universitetin Barleti bazohet në materializimin e konceptit “Student potencial”. Për këtë:

Universiteti krijon marrëdhënie partneriteti me institucione të ndryshme, vendase e të huaja, si institute kërkimore, shoqata profesionale, kompani biznesi etj., për zhvillimin e tij në drejtime me interes të ndërsjellët me partnerët (Aneksi 7, bashkëngjitur “Marrëveshja me Institutin e Sociologjisë”).

Në raste të veçanta, në bashkërendim me partnerët dhe për interesa të veçanta të tyre e të shoqërisë, mund të organizohen programe studimi të veçanta e me tarifa preferenciale, ose me tarifa pjesërisht të sponsorizuara nga universiteti.

Universiteti, sipas mundësive, vendos ura bashkëpunimi institucional me institucionet e arsimit parauniversitar, publik dhe jopublik (Aneksi 8, “Marrëveshje tip, komunikimi dhe mënyra e kontaktimit me shkollat e mesme”). Në to parashikohen testime e sondazhe për të njohur synimet e studentëve potencialë, shkëmbimi i materialeve dhe organizimi i veprimtarive informuese, zhvillimi i leksioneve, lektoriumeve, drejtimi i veprimtarive shkollore e

jashtëshkolllore nga pedagogë të universitetit e deri ofrimi i disa shërbimeve (si kurse të certifikuar etj.) për nxënësit e viteve të fundit të shkollës së mesme.

DÇS, në bashkëpunim me partnerët e Universitetit “Marin Barleti”, në muajt prill-maj të çdo viti akademik, realizon një sondazh me nxënës të viteve të ndryshme të shkollave të mesme, kryesisht me vitet e fundit (Aneksi 9, “Pyetësi i sondazhit me nxënësit e shkollave të mesme”). Realizimi i tij shoqërohet me fushatën e informimit dhe prezantimit të ofertës “Marin Barleti”.

Realizimi i sondazhit me nxënësit e shkollave të mesme dhe informimi mbi ofertën “Marin Barleti” është kriter i rëndësishëm për vlerësimin dhe dhënien e statusit “Bashkëpunëtor” e deri “Ambasador” i Universitetit “Marin Barleti” (shih, në vijim, “7. Partnerët, bashkëpunëtorët, ambasadorët”).

Mbi bazën e informacionit të marrë nga tre tipet e sondazheve (sondazhet e realizuara me studentët për vlerësimin e brendshëm (të përgjithshëm dhe sipas moduleve), me studentët para diplomimit (duke përfshirë edhe studentët e universiteteve të tjera), si dhe me nxënësit e shkollave të mesme dhe individë të tjerë që kanë kryer shkollën e mesme para një, dy apo më shumë vitesh, krijohet banka të dhënave, në sistemin SPSS (apo në ndonjë sistem tjetër kompjuterik).

Nga banka e të dhënave që sigurohet nga sondazhi me nxënësit e shkollave të mesme diferencohen individët e përfshirë në sondazh katër kategori/shkallëzime, sipas probabilitetit të vlerësuar të përfshirjes në Universitetin “Marin Barleti”. Mbi këtë bazë krijohen rrjetet në tre nivele (studentë perspektivë; studentë aktivë dhe alumni). Mbi këtë bazë vendosen kriteret e përzgjedhjes (1), kontaktet (2) dhe ndërtohet puna e diferencuar për tërheqjen dhe regjistrimin (3) në Universitetin Barleti.

## **B. Të tjera çështje mbi përzgjedhjen e studentëve**

Departamentet e Universitetit Barleti, në përputhje me specifikën e programit të studimit që ata realizojnë, hartojnë “Kriteret e pranimit të studentëve”, duke vlerësuar notën mesatare, atë të maturës shtetërore, rezultatet në lëndë (disiplina) të veçanta të afërta me programin konkret të studimit etj.

Në “Kriteret e pranimit të studentëve” parashikohen edhe “Përgatitja e studentëve para se të futen në programet e studimit” dhe parakushtet respektive (Aneksi 10, bashkëngjitur “Kriteret e pranimit të studentëve”, modeli).

Në qoftë se studentët nuk arrijnë të përfundojnë studimet brenda afatit optimal të parashikuar, atëherë atyre u krijohet mundësia e përfundimit të tyre për një kohë më të gjatë. Provimet që japin studentët pakalues dhe ata që nuk kanë marrë pjesë në provim jepen pa pagesë.

### **C. Prezantimi i ofertës “Marin Barleti”**

Prezantimi i ofertës “Marin Barleti” drejtohet nga një zyrë e veçantë: “Zyra e Marrëdhënive me Sistemin Parauniversitar” (ose zyra e rekrutimit).

Prezantimi i ofertës “Marin Barleti” bëhet përmes veprimtarive të vazhdueshme sensibilizuese, në media dhe në komunitete (të veçanta, apo veprimtari të ndryshme ku përfaqësues të universitetit janë pjesëmarrës). Në përgatitjet e çdo viti akademik parashikohet prezantimi i ofertës “Marin Barleti” në shkollat e mesme të rretheve të ndryshme, e në forma të tjera (media etj.). Prezantimet në shkollat e mesme të rretheve të ndryshme bëhen sipas një plan-kalendari të veçantë.

Prezantimi i ofertës “Marin Barleti” konsiston në informimin e të interesuarve sidomos për **anët e forta** të Universitetit “Marin Barleti”, siç janë:

Mjedis universitar me një identitet të qartë kulturor; komunitete kompakte dhe mundësi për zhvillimin dhe rritjen e kapitalit social gjatë studimeve dhe pas përfundimit të tyre;

Një institucion arsimor i bazuar tërësisht mbi cilësinë, në disa plane: si cilësi mësimore - akademike, si cilësi diplomash, si cilësi marrëdhëniesh student-personel akademik, si cilësi shërbimesh për studentët, si marrëdhënie cilësore komunitare me studentët e diplomuar, bashkëpunëtorët, ambasadorët, partnerët, sipërmarrjet, sferën publike etj.

Trajtimi i çështjeve studentore nga rektorati, përmes një strukture të veçantë (Divizioni i Çështjeve Studentore), të përbërë nga një staf i kualifikuar për shërbimet studentore, në të gjitha nivelet;

Mjedis universitar cilësor, në zonën më piktoreske të Tiranës, pranë Parkut Kombëtar dhe Liqenit Artificial, me mundësi të shumta zhvillimi, aktivizimi dhe argëtimi;

Programet të akredituara e të kombinuara studimi, diploma me orientime shtesë (formim bazë + minor);

Orientimi i procesit mësimor akademik drejt profesionalizmit të kontingjenteve që dalin nga universiteti;

Orientim i karrierës përmes një zyre të veçantë;

Grupet e vogla të studimit me mundësi zhvillimi interaktiv të veprimtarive mësimore;

Tutoriali, sipas sistemit “një për një: një student një tutor”;

Integrimi i mësim dhënes dhe të nxënit me kërkimin shkencor dhe përfshirja e studentëve në projekte të kërkimit shkencor;

Bashkërendim i mësimdhënies me institucionet partnere dhe sipërmarrjet, mundësi orientimi në tregun kombëtar e ndërkombëtar të punës;

Një mjedis anglishtfolës universitar, shkëmbime studentësh me universitete të huaja, mundësi njohjeje dhe vizitash gjatë studimeve të institucioneve evropiane e ndërkombëtare;

Mjete didaktike bashkëkohore dhe shërbime të shumanshme për studentët;

#### **D. Publikimi dhe mediatizimi i ofertës “Marin Barleti”**

Publikimi dhe mediatizimi i “Ofertës Barleti”, parashikon gjithashtu:

Bashkëpunim me mediat, i konsideruar si mundësia më e mirë për t’i bërë jehonë publike “Ofertës Barleti”. Përveç njoftimeve publike për programe të veçanta dhe reklamave, parashikohet marrëdhënia me këmbim të ndërsjellët interesash Universitet “Marin Barleti” - Media. Në mënyrë më të detajuar parashikohet organizimi i programeve televizive, pjesëmarrja e studentëve dhe pedagogëve të Universitetit “Marin Barleti” në emisionet në TV e në Radio, në debate publike - sidomos ato të lidhura me arsimin e lartë - në konkurse, lojra mediatike etj.

Për shpjegimin e ofertës “Marin Barleti” organizohen “Ditët e hapura”. Organizimi i tyre bëhet sipas programeve të studimit (departamenteve), përfshihen/listohen në kalendarin vjetor të aktiviteteve dhe publikohen në web-sitin e universitetit.

Për prezantimin e ofertës “Marin Barleti” mund të shfrytëzohen edhe grumbullimet publike në raste festash etj., me organizime të veçanta, me tenda, bluza, kapele “Marin Barleti”, shoqëruar edhe me shërbime të caktuara të barletasve për qytetarët etj., etj.

#### **E. Politikat e motivimit (bursa, sponsorizime studimesh)**

Universiteti “Marin Barleti” akordon bursa të plota, apo të pjesshme, për studentë të kategorive të ndryshme, si:

Studentë që në vitin paraardhës (viti i fundit i shkollës së mesme, apo viti paraardhës në universitet) kanë arritur rezultate “të shkëlqyera” dhe “shumë të mira”

Talente të njohura në nivel kombëtar të fushave të ndryshme, si muzika, letërsia, artet figurative, sporti etj.

Studentë me disavantazhe shoqërore, studentë nga shtresa të margjinalizuara, me aftësi fizike të kufizuara, studentë që përjetojnë fatkeqësi familjare, studentë statusi ekonomik i familjeve të cilëve ndryshon për arsye objektive etj. (Aneksi 11, bashkëngjitur “Bursa për studentët” dhe komisioni);

Studentët e këtyre kategorive mund të aplikojnë pranë DÇS për akordim burse, në fund të çdo semestri e, për raste fatkeqësish, në çdo kohë.

Shqyrtimi i kërkesave bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Tarifave dhe Bursave.

Universiteti "Marin Barleti", si bartës dhe përcues i vlerave të humanizmit, mund të sponsorizojë programe studimi për degë, profile dhe kategori shërbimesh e profesioneve me interes të veçantë publik dhe kombëtar.

## **5. ORIENTIMI DHE SHËRBIMET PËR STUDENTËT**

Shërbimet ndaj studentëve trajtohen nga DÇS, përmes disa sektorëve apo zyrave, çdonjëra prej të cilave punon me një platformë në të cilën përshihen objektet, kompetencat dhe përgjegjësitë e individëve të ngarkuar.

Parimi bazë në marrëdhëniet e universitet - student është rigoroziteti dhe serioziteti: *ajo që merret përsipër bëhet, ajo që nuk mund apo nuk duhet të bëhet, nuk merret përsipër.*

Në strukturën e orientimit dhe shërbimeve për studentët përfshihen:

### **A. Orientimi i studimeve dhe i karrierës**

Zyra për "Orientimin e studimeve" orienton studentët në përzgjedhjen e programeve të studimit, në funksion të zhvillimit të karrierës së tyre. Ajo mundëson informimin dhe këshillimin, duke filluar me të interesuarit për të ndjekur studimet pranë Universitetit "Marin Barleti" e deri në Orientimin e karrierës për studentët në prag të diplomimit dhe për të diplomuarit (alumni, shih). Ajo bashkërendon veprimtarinë e vet me sektorët e tjerë të ngarkuar për çështjet studentore.

### **B. Tutoriali**

Për të ndihmuar zhvillimin personal e profesional të studentit, ecurinë normale në të gjithë procesin e shkollimit funksionon sistemi i tutorialit. Tutoriali në Universitetin "Marin Barleti" i referohet përvojës së universiteteve që shquhen për raportin pedagog-student. Ai bazohet në parimin e përfshirjes së çdo studenti në sistemin e tutorialit. Në rregulloret e departamenteve të përcaktohen edhe kriteret e institucionalizimit të tutorialit dhe mënyrën e monitorimit të funksionimit të tij. Departamentet, në fund të muajit të parë të vitit akademik, dorëzojnë pranë GÇS listën e studentëve dhe tutorëve të tyre.

### **C. Studentët në prag të diplomimit**

Universiteti "Marin Barleti" bën, çdo vit, sondazhe me studentët në prag të diplomimit të tyre, duke synuar:

1. Evidencimin e problemeve të brendshme dhe orientimin për ndërtimin e strategjive të zhvillimit të tij;

2. Pritshmëritë dhe interesat e tyre mbi tregun e punës dhe mundësinë e vijimit të studimeve pasuniversitare, drejtpërdrejt ose pa shkëputje nga puna;

3. Universiteti krijon bankën e të dhënave të këtyre sondazheve dhe ndjek zhvillimin e karrierës së studentëve alumni;

Universiteti, përmes kurrikulave dhe aktiviteteve ekstra kurrikulare, punon për ndërgjegjësimin e studentëve ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me etikën e biznesit dhe përgjegjësitë sociale e kolektive të tyre;

Universiteti, përmes Zyrave përkatëse (të Orientimit të Studimeve dhe Zhvillimit e karrierës) dhe Zyrës së Marrëdhënieve me Komunitetin, organizon çdo vit *Javën e karrierës*, në të cilën përfshihen:

Seanca trajnimesh për të orientuar studentët që diplomohen për tregun e punës, për hartimin e CV-ve, mënyrën e kërkimit të punës, teknikat e aplikimit etj.;

Organizimi në mjediset e tij, i *panaireve të punës* me kompanitë partnere dhe kompani të tjera, vendase e ndërkombëtare, përmes të cilave ai u ofron studentëve të tij mundësi aplikimi për punësim, në përputhje me formimin e tyre;

Takime e veprimtari orientuese me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë të Shqipërisë dhe të huaja që veprojnë në vend, duke lehtësuar ndërmjetësimin e punësimit të studentëve, sikundër edhe me biznese të veçanta.

#### **D. Studentët e diplomuar (Alumni)**

Studentët e diplomuar (alumni), konsiderohen pjesë organike e komunitetit “Marin Barleti”. Cilësia e marrëdhënieve të Universitetit “Marin Barleti” me studentët e tij që kanë kryer studimet, konsiderohet si një ndër kriteret bazë të vlerësimit të cilësisë së vetë universitetit.

Marinbarletasit alumni trajtohen nga një zyrë e veçantë e universitetit. Ata gëzojnë një status të veçantë (Aneksi 2, bashkëngjitur “Statusi i studentit/Barletasit Alumni”), në të cilin parashikohet edhe një paketë përfitimesh dhe shërbimesh në ndihmë të tyre, nga universiteti siç mund të jenë: trajnime e kurse periodike, aktivitete formimi e argëtimi, akses në biblioteka, rrjete, programe kompjuterike si dhe botime (broshura, newsletter, revista) etj.

Ata, nën drejtimin e Zyrës së Alumni-t dhe orientimit të karrierës, formojnë *rrjete të komunikimi* virtual, marrin pjesë në debate on-line si dhe në forume të departamenteve të universitetit. Në të ardhmen mund të krijohen rrjete të diferencuara komunikimi, sipas viteve të shkollimit, përkatësive të tyre profesionale (degëve, fushave), përkatësive gjinore, moshore etj., sipas interesave të veçanta (hobeve) të tyre, si dhe sipas vendit të banimit dhe punësimit (sipas qarqeve) etj.

Me studentët alumni mund të krijohet *Shoqata “Marin Barleti”*, si një mekanizëm për institucionalizimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit të barletasve me njëri-tjetrin, si dhe me zyrën alumni, departamentet, fakultetet dhe rektoratin e Universitetit “Marin Barleti”.

Studentët alumni ftohen për zhvillimin e karrierës së tyre në bashkëpunim me universitetin. Ata, sipas mundësive, ftohen për të marrë pjesë në projekte të Universitetit Barleti. Në raste të veçanta, universiteti krijon infrastrukturën e nevojshme për institucionalizimin dhe realizimin e projekteve të studentëve të tij alumni.

Studentët alumni ftohen për të qenë referues, moderatorë dhe pjesëmarrës të konferencave e video-konferencave, të simpoziumeve, forumeve e aktiviteteve të tjera periodike të universitetit etj.

Universiteti bën sondazhe periodike, krijon bankën e të dhënave dhe publikon (on-line e në forma të tjera), studime në lidhje me vendosjen e studentëve të tij alumni në tregun e punës dhe gjithë problematikën e ballafaqimit të tyre në tregun vendas dhe ndërkombëtar të punës.

Universiteti Barleti merr përsipër edhe organizimin e kurseve afatshkurtra, apo edhe të programeve të veçanta të studimit, për modelimin e formimit të studentëve alumni, për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës dhe dinamikës së zhvillimit.

Studentët alumni ftohen dhe ndihmohen për të qenë pjesëmarrës dhe organizatorë sidomos të aktiviteteve të *Javës së barletasve*.

## **6. Të tjera shërbime për studentët**

DÇS interesohet dhe, në bashkëpunim me zyrat dhe strukturat e tjera të universitetit, siguron shërbime cilësore bashkëkohore për studentët, siç janë:

### **A. Biblioteka:**

Veç bibliotekës ekzistuese, parashikohet zgjerimi i bibliotekës së universitetit dhe krijimit të *Bibliotekës on-line Marin Barleti*. Parashikohen përfshirja e periodikëve shkencorë, vendase dhe ndërkombëtare, si "Wall Street Journal", "The Economist" etj.

### **B. Shërbimet akademike dhe administrative të informatikës**

Infrastruktura e teknologjisë së informacionit, kabineti i kompjuterëve, Lap top-ët, shërbimi i internetit (duke përfshirë shërbimin wireless), shërbimet informatike administrative (shpërndarjen e informacionit për studentët në lidhje me provimet, rezultatet, detyrimet etj., nga sekretaria mësimore etj.).

### **C. Aktivitetet universitare; Zyra e aktiviteteve**

DÇS angazhohet që Universiteti "Marin Barleti" të shndërrohet në një *Qendër të madhe kombëtare të veprimtarive shkencore dhe kulturore*. Ai synon integrimin e aktiviteteve ndihmëse me programet e formimit profesional dhe qytetar të studentëve, integrimin sa më të gjerë të aktiviteteve studentore me ato akademike si dhe përfshirjen sa më të madhe të studentëve dhe organizatave të tyre si organizatorë e bashkë-organizatorë të aktiviteteve.

Për planifikimin, realizimin e aktiviteteve cilësore e të bashkërenduara me rektoratin, fakultetet e departamentet, si dhe me Unionin Studentor, Këshillat e Studentëve, rrejetet dhe organizatat studentore e të alumni-it etj., krijohet Zyra e Aktiviteteve të Universitetit Barleti.

Zyra e Aktiviteteve të Universitetit “Marin Barleti” publikon, në fillim të çdo viti akademik, kalendarin e aktiviteteve që do të realizohen në 30 javët e vitit akademik.

*Synohet që çdo javë të ketë të paktën një aktivitet.*

Hartimi i kalendarit të aktiviteteve bëhet nga:

Departamentet, çdo departament duhet të organizojë të paktën një aktivitet për semestër;

Fakultetet dhe Universiteti, vetë ose në bashkëpunim me partnerët e tyre;

Kalendari i aktiviteteve hartohet duke mbajtur parasysh edhe kalendarin kombëtar e ndërkombëtar të ngjarjeve e datave (Aneksi 12, bashkëngjitur “Ditët e veçanta kombëtare e ndërkombëtare” dhe “Kalendari i Aktiviteteve të Universitetit Marin Barleti”). Synimi të jetë: përputhja, sa më madhe e aktiviteteve të universitetit (të studentëve e personalit akademik) me “Ditët e veçanta, kombëtare dhe ndërkombëtare”. Kjo edhe me qëllim që të mundësohet pranueshmëria e pasqyrimin në media, publiciteti dhe jehona sa më e madhe publike e tyre.

#### **D. Jeta studentore jashtë-universitare**

Organizimi i aktiviteteve jashtëshkollore, si mbrëmje festive, ekskursionet, organizime sportive, udhëtime brenda dhe jashtë Shqipërisë etj.

Universiteti “Marin Barleti” është i pari universitet në Shqipëri që ka një ekip sportiv, konkurrues në nivel kombëtar. Ekipi i volejbollit “Marin barleti Volley”, i krijuar në vitin 2005, fitoi gjatë sezonit sportiv 2008–2009 kupën e Shqipërisë në volejball për femra, duke i dhënë universitetit të parin trofe në nivel kombëtar.

DÇS, në bashkërendim me drejtuesit e universitetit dhe kompanisë, synon që kjo përvojë të çohet më tej e të pasurohet edhe me organizime të tjera.

#### **E. Akomodimi**

Megjithëse studentët jetojnë me familjet e tyre, ose ndajnë së bashku apartamente të marra me qira, DÇS - duke respektuar zgjedhjet e studentëve - përmes një agjencie të specializuar, kujdeset dhe krijon mundësinë që studentët të akomodohen në kushte favorizuese, të jenë sa më afër njëri-tjetrit dhe universitetit e të zhvillojnë kapitalin social.

#### **F. Qendra e këshillimit psiko-social**

Studentët mund të drejtohen për konsultime e këshillime edhe në qendrën e këshillimit psiko-social. Kjo qendër funksionon sipas një grafiku të caktuar. Shërbimi kryhet nga një këshillues ekspert (terapist) i jashtëm.

## **7. PARTNERËT, BASHKËPUNËTORËT, AMBASADORËT**

### **A. Partnerët:**

Për realizimin e misionit të tij, DCS mbështetet në marrëveshjet e partneritetit të Universitetit "Marin Barleti" me Partnerët Strategjikë të tij, me universitete vendase e të huaja, me organizata e shoqata, me institucione, kompani e grupe të biznesi etj.

### **B. Bashkëpunëtorët**

Puna e DCS bazohet sidomos në rrjetin e bashkëpunëtorëve të Universitetit "Marin Barleti". Bashkëpunëtor i Universitetit "Marin Barleti" mund të jetë çdo person i interesuar për të bashkëpunuar e për të zhvilluar me të interesa të ndërsjellta legjitime, në funksion të përmbushjes së misionit të tij.

Bashkëpunëtorët e Universitetit "Marin Barleti" përbëjnë një ndër institucionet e tij. Ata formojnë një rrjet të veçantë dhe kanë një status të veçantë (Aneksi 13, bashkëngjitur, "Statusi i bashkëpunëtorëve dhe Ambasadorëve të Universitetit "Marin Barleti"").

Në përzgjedhjen e rrjetit të bashkëpunëtorëve mbahen parasysh kontributi kundrejt universitetit, imazhi publik i personave që fitojnë këtë status, si dhe lidhjet e mëparshme me universitetin (së pari synohet që barletasit alumni të bëhen e mbeten bashkëpunëtorë të universitetit).

### **C. Ambasadorët**

Institucioni i Ambasadorëve të Universitetit "Marin Barleti" përfaqëson *statusin më të lartë të bashkëpunimit me të*. Ambasadorët zgjidhen nga radhët e bashkëpunëtorëve, sipas kriterëve të paracaktuara, bazuar në kontributet kundrejt universitetit dhe imazhin publik të tyre.

Ambasadorët janë përfaqësues publikë të Universitetit "Marin Barleti".

Ambasadorët kanë një status të veçantë dhe përfitojnë "Kartën e ambasadorit". Karta e ambasadorit jepet në ceremoni të veçanta dhe është bartëse e disa të drejtave, përfitimeve apo shërbimeve të rendit vlerësues (moral), apo edhe material (siç mund të jene studimet me pagesë të reduktuar, abonime të sponsorizuara nga universiteti etj.).

Ambasadorët e Universitetit "Marin Barleti" bëhen publikë me fotot dhe një CV të shkurtër (rreth 50 fjalë) në faqen zyrtare të universiteti në internet, e në forma të tjera.

## **8. NDËRKOMBËTARIZIMI I STUDENTËVE**

DÇS, në bashkërendim me institucione të tjera brenda e jashtë universitetit, siç janë Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare etj., punon për ndërkombëtarizimin e studentëve të Universitetit “Marin Barleti”, duke e konsideruar si një parakusht për akreditimin ndërkombëtar të tij, kryesisht përmes:

Rritjes së cilësisë akademike deri në nivele të krahasueshme me universitete të vendeve perëndimore;

Rritjes së gatishmërisë së studentëve për t’u menaxhuar në kontekstin ndërkombëtar;

Ofertave për studentët më të shquar të tij për të konkurruar për intershipe, bursa e punësime në institucione jashtë Shqipërisë;

Shkëmbimit të studentëve, krahas personelit akademik;

Shërbimit që u ofrohet studentëve ndërkombëtarë;

### **Krijimi i komunitetit anglishtfolës “Marin Barleti”**

DÇS e konsideron praninë e gjuhës angleze në mjedisin universitar, si kusht të domosdoshëm për të krijuar një përvojë origjinale ndër universitetet shqiptare e më gjerë, një çelës për rritjen e prestigjit publik të universitetit dhe për rritjen e sasisë dhe cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve e personelit akademik.

Prania e anglishtes në mjedisin universitar përbën një kusht për transferimin e krediteve, shkëmbimin e studentëve dhe pedagogëve me universitete të tjera dhe për akreditimin ndërkombëtar të Universitetit “Marin Barleti” (Aneksi 14, bashkëngjitur: “Master-plan për një komunitet anglishtfolës”, në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhëve Moderne dhe komunikimit).

### **9. DIVIZIONI I ÇËSHTJEVE STUDENTORE, ÇËSHTJET QË MBULOJNË, KONTAKTET**

Personi i ngarkuar	Çështjet që mbulon	Kontaktet	
		E-mail +	Telefon
Lekë Sokoli	Prorektor i Çështjeve Studentore	prorektorst	0692032731
Jonida Lamaj	Asistente, ndërkombëtarizimi i studentëve (Rekrutimi)	asprorektorst	
	Zyra e Marrëdhënieve me sistemin parauniversitar (Admission - Pranimi)		
Valbona Alikaj	Zyra e orientimit të studimeve	këshillimi	0692062086

Erjon Kristo	Zyra e jetës studentore (Unioni, botimet, organizata)	qstudentore	0692084437
Daniel Jaçe	Zyra e aktiviteteve kulturore dhe artistike	studentaktivitete	0692409633
Gentiana Qose	Zyra e aktiviteteve sportive studentore	sportaktivitete	0693370266
Jorida Rustemi	Këshillimi psiko-social	stmkoord	0692875566
Igli Totozani	Zyra e orientimit të karriës (Studentët alumni)	Alumni	0692283676
<b>Në vartësi të dyfishtë</b>			
Klea Puraveli	Regjistrimet (GÇS + Administrata)	regjistrime	
Ornela Shqarri	Financat (GÇS + Administrata)		
Blendi Salaj	Mediat (Komunikim + GÇS)	Media	
Bora Kuçuku	Kom. i brendshëm (Komunikim + GÇS)	komunikim	
Rediana Curraj	Interneti (Komunikim + GÇS)	emarketing	
Amir Akhtar	Adm. i Web-it (Komunikim + GÇS)	webadmin	
Gazmend Malo	Merketingu (Komunikim + GÇS)	marketing	
Linda Bubesi	Biblioteka (GÇS + Adm)	biblioteka	
Silio Stefani	Shërbimet e informatikës		
	Libraria dhe shërbime të tjera		

## 10. DIVIZIONI I ÇËSHTJEVE STUDENTORE

